



Pranuar / Dorezuar Prijmjeno/Prilato Received/Deliverty	29.06	2021	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHOK	3373/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.529/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti, anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.529/2021 të datës 11.06.2021 të parashtruar nga ankuesja _____ nga Prishtina, kundër organit të punësimit Komisioni i Pavarur i Mediave, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 28.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.529/2021e datës 11.06.2021, e parashtruar nga ankuesja _____
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër reference 2109/689/EXD/II i datës 08.06.2021 i Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur për Media.
- III. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i Komisionit të Pavarur për Media për zbatimin e këtij vendimi në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja _____ Zyrtare e Lartë për Monitorim Regjional, në Komisionin e Pavarur për Media, me datë 11.06.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3023/2021 të regjistruar me numër A.nr.529/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me numër të referencës 2109/689/EXD/II të datës 08.06.2021 të Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur për Media.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës pasi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet për pranueshmerinë e ankesës siç përcaktohet me nenin 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të datës 07.04.2021 e parashtruar

në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e Kryeshefes Ekzekutive të Komisionit të Pavarur për Media e datës 25.10.2018; Vërtetimin e datës 05.03.2020 për statusin e studimeve; Vendimin e datës 11.03.2021 të Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur për Media; Kërkesën e ankueses të datës 11.05.2021 me numër të protokollit 2315/2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit e ankueses të datës 02.08.2011; Përshkrimin e detyrave të punës i datës 15.09.2011; Kërkesën e ankueses të datës 10.02.2021 e parashtruar në Komisionin e Pavarur për Media për pushim pa pagesë; Rekomandimi i datës 03.03.2021 i Udhëheqëses së Divizionit për Monitorim dhe Analizë i Komisionit të Pavarur për Media; Vendimin e datës 09.07.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komisionit të Pavarur për Media; e-mailin e datave 02.03.2020, 04.03.2020, 12.03.2020 dhe 16.03.2020; Kërkesën e ankueses për pushim pa pagesë e datës 02.03.2020; Vendimin e datës 25.10.2018 e Kryeshefes Ekzekutive të Komisionit të Pavarur për Media; Kërkesa e ankueses e datës 16.10.2018 për pushim pa pagesë e parashtruar në Komisionin e Pavarur për Media; e-mail i datave 16.10.2018, 23.10.2018 dhe 24.10.2018; Vendimin e datës 23.03.2020 të Kryeshefes Ekzekutive të Komisionit të Pavarur për Media, Ankesën e ankueses së datës 11.06.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin A.nr.255/2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 08.06.2021 të Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur për Media si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses dhe pas analizimit të të gjitha provave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankueses *është e bazuar, sepse:*

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës gjegjësisht sipas Akt Emërimit të datës 01.08.2011, Kolegji ka konstatuar se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës "Zyrtare e Lartë për Monitorimin Regjional, në Departamentin për Monitorim dhe Analizë pranë Komisionit të Pavarur për Media (me tej KPM). E njëjta me datë 10.02.2021 ka parashtruar kërkesë të Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt gjegjësisht të Udhëheqësi i Departamentit për Monitorim dhe Analizë, për pushim pa pagesë për arsye të vazhimit të studimeve master, në Universitetin e Evropës Juglindore të Tetovës në programin-studime të Diplomacisë, për përudhen kohore nga data 01.04.2021 deri 31.03.2022.

Kryeshefi Ekzekutivi i KPM-së, me Vendimi me numër 2103/313/EXF/LL të datës 11.03.2021, ka refuzuar kërkesën e ankueses të datës 10.02.2021. Kundër këtij vendim ankuesja me datë 07.04.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, i cili me vendimin me numër A.Nr.255/2021 të datës 21.05.2021, ka aprovuara ankesën e ankueses, ka shfuqizuar Vendimin me numër 2103/313/EXF/LL të datës 11.03.2021 të Krye shefit Ekzekutiv të KPM-së, dhe të njëjtin e ka detyruar që të rishqyrtoj kërkesën e ankueses të datës 10.02.2021.

Në zbatim të Vendimit me numër A.Nr.255/2021 të datës 21.05.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, Kryeshefi Ekzekutiv i KPM-së me Vendimin me numër reference 2109/689/EXD/II të datës 08.06.2021, serish ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e ankueses për pushim pa pagesë për qëllime të ngritjes profesionale.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, ka analizuar dispozitave ligjore të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës përkatësisht nenin 40 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ku është përcaktuar se: *1.Nëpunësit civilë kanë të drejtë në:1.4. pushim pa pagesë.* Ndërlidhur me këtë Rregullorja Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve



Civilë respektivisht neni 8 paragrafi 1.4 ka përcaktuar se: 1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë në pushime të veçanta, të cilat janë:.....1.4. pushimi pa pagesë, ndërsa neni 15 i po kësaj Rregullore parasheh se : Pushimi pa pagesë mund të autorizohet në raste të veçanta nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit punëdhënës, si në vijim: 1.1. Për ngritjen profesionale për nevojat e vetë nëpunësit civil,..... 2. Pas kalimit të periudhës së pushimit pa pagesë, nëpunësi civil e ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme apo ekuivalente me të, dhe si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtën në pushim pa pagesë për arsye të ngritjes profesionale dhe i njëjti me përfundimin e pushimit pa pagesë, ruan të drejtën e kthimit në vendin e tij të punës të mëparshëm apo në një pozitë të ngjashme ekuivalente, e në këtë kuptim Kolegji vlerëson se është i bazuar pretendimi i ankueses që ti mundësohet pushim pa pagesë lidhur me aftësimin profesional respektivisht për vazhdimin e studimeve master, ashtu siç është përcaktuar në kërkesën e ankueses me numër reference 2102/147/DMA/mt, të datës 10.02.2021.

Në pajtueshmëri me dispozitat ligjore si me lartë, ankuesja bartë detyrimin e njoftimit të organit të punësimit lidhur me ndërprerjen, ndryshimin si dhe përfundimin e programit për aftësim profesional si dhe obligimin e shfrytëzimit të së drejtës për pushim pa pagesë vetëm brenda periudhës kohore të lejuar me vendimin e organit të punësimit.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka konstatuar se Kryeshefi Ekzekutiv i KPM-së me rastin e rishqyrtimit të kërkesës së ankueses të datës 10.02.2021 sipas Vendimit me numër të referencës 2109/689/EXD/II të datës 08.06.2021, nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike lidhur me çështjen kontestuese.

Bazuar në rrethanat si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.529/2021

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Valentina Kaçandolli
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur për Media;
- Udhëheqëses së Personelit në Komisionin e Pavarur për Media dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së